

NOTE INFORMUESE

Mbi kërkesën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë drejtuar KLGJ-së, për shkarkimin nga detyra të gjyqtarit SH.M.

Tiranë, më 20 Tetor 2020

Inspektori i Lartë i Drejtësisë parashtroi sot para Këshillit të Lartë Gjyqësor argumentet për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit SH.M. me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Apelit Tiranë, për shkelje disiplinore të parashikuar nga neni 140 pika 2, shkronja “b” e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe nga neni 104/3 i ligjit nr. 96/ 2016 “Për statusin e gjyqtarit dhe të prokurorit në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

Magjistrati SH.M. është deklaruar fajtor nga ish Gjykata e Apelit për Krime të Rënda Tiranë më 27.02.2019 për veprën penale “Korrupsioni pasiv i gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, të parashikuar nga neni 319/ç të K.Penal.

Referuar fakteve dhe rrethanave të pranura nga gjykata, rezulton se:

- Veprimet e gjyqtarit kanë cenuar veprimtarinë e rregullt të organeve të drejtësisë nga veprimet e parregullta të personave të jashtëm por edhe nga veprimet e vetë atij si funksionar i drejtësisë.
- Këto veprime kanë cenuar besimin e palëve ndërgjyqëse dhe të publikut në organet e drejtësisë dhe respektimin e ligjit nga ana tyre, si dhe kanë diskretituar rëndë pozitën dhe figurën e magjistratit.
- Ushtrimi i pa rregullt i detyrës nga ana e magjistratit ka sjellë pasoja për dhënien e drejtësisë, ka diskretituar rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit, si dhe ka cenuar besimin e publikut te drejtësia.

Duke mbajtur në konsideratë natyrën e shkeljes disiplinore, ajo e kryerjes së një krimi për të cilin është dënuar me vendim të formës së prerë, të parashikuar nga neni 140/2 shkronja b) e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 104 i ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; faktin që shkelja disiplinore në rastin konkret përbën “Shkelje shumë të rëndë disiplinore”; provohet se magjistrati Shkëlqim Miri ka diskretituar pozitën dhe figurën e magjistratit, ka cenuar rëndë imazhin e drejtësisë dhe ka ulur besimin e publikut tek dhënia e drejtësisë.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë i kërkon Këshillit të Lartë Gjyqësor fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit Shkëlqim Miri dhe caktimin ndaj tij të masës disiplinore “Shkarkim nga detyra”.